

## AKT THEMELIMI DHE STATUT

### I SHOQËRISË TREGTARE "FUTURIS GEN" Sh.p.k.

**"Zurich Investment Group" shpk**, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në datë 25.06.2021, me NIPIT M11825004M, me adrese në Rrugë të Kosovareve, Pallati "Dolçka", Apartamenti 1/2, Njesia Administrative nr. 5, Tiranë, përfaqësuar nga administratori **Alban Efthimi**, i biri i Romeos, lindur në Tiranë me 13/10/1970 dhe banues në Tiranë, madhorr me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me kartën e identitetit Nr. 036022174 dhe Nr. H01013093A, në përputhje me Vendimin e Asamblesë Nr. 2, datë 14.07.2023.

**Armand Metani**, shtetas shqiptar, i biri i Albert, lindur në Barçë, me 02.04.1989, banues në Tiranë, identifikuar me kartën e Identitetit Nr. 033026825 dhe Nr. Personal I904020660.

**Altin Premti**, shtetas shqiptar, i biri i Veliut, lindur në Vlorë, me 30.08.1971 dhe banues në Tiranë, identifikuar me kartën e Identitetit Nr. 033380188 dhe Nr. Personal H10830113G.

**Andi Efthimi**, shtetas shqiptar, i biri i Romeos lindur në Tiranë, me 04.01.1978, banues në Tiranë, identifikuar me kartën e Identitetit Nr. 033198809, dhe Nr. Personal H80104093K.

**Olsi Efthimi**, shtetas shqiptar, i biri i Romeos lindur në Tiranë, me 04.01.1978, banues në Tiranë, identifikuar me kartën e Identitetit Nr.035030169, dhe Nr. Personal H80104094S.

Për të bërë të mundur organizimin dhe ushtrimin e veprimtarisë ekonomike të kësaj Shoqërie, në përputhje me Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar (Ligji Tregtar) dhe Ligjin Nr.131/2015 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit" (Ligji QKB), Ortakët e cilësuar më sipër, miratojnë Statut dhe Akt Themelimi me përmbajtjen si më poshtë:

#### KREU I

#### DISPOZITA TË PËRGJITHSHME


##### *Neni 1*

Shoqëria Tregtare emërtohet FUTURIS GEN Sh.p.k.

##### *Neni 2*

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë tregtare do të jetë:

---




- Kryerja dhe realizimeve i punimeve të ndërtimit, riparimit, rikonstruksionit, rindërtimit dhe shtesave, instalime të çdo lloji të objekteve të paluajtshme, duke përfshirë godinat dhe objektet ekzistuese, të objekteve publike apo private, punimeve civile, sistemeve teknike elektrike, mekanike, hidroteknike, veprave të artit si edhe çdo lloj ndërtimi i ri;
- Aktivitete tregtare dhe qiramartja e qiradhenja e mjeteve te prodhimit dhe ndertimit te te gjitha llojeve;
- Prodhimi, shitja dhe shperndarja e elementeve prej betoni te armuar;
- Realizimi i instalimeve elektrike dhe montimi i linjave elektrike;
- Mbajtja e raporteve te kontabilitetit per bizneset e ndertimit;
- Dhenia me qira dhe marrja me qira e pasurive te paluajtshme;
- Zhvillimi i investimeve dhe zbatimi i projekteve ndertimore;
- Sipermartja dhe realizimi i ndertimeve në lartësi dhe në thellësi; i tuneleve; digave;
- Realizimi i punimeve ndertimore ne fushen e transportit si: rruge, ura, vepra arti ne infrastrukture, tunele, porte, aeroporte, metro, etj.
- Zbatimi, mirëmbajtja dhe investimi në infrastrukturën energjitike, ndërtime të strukturave energjitike me teknologji dhe burime: hidro, diellore, të erës, gjeotermale, të energjisë së rinovueshme dhe të green energy;
- Zbatimi, mirëmbajtja dhe investimi në projekte të efikasitetit energjitike;
- Sipermartja e ndertimeve te te gjitha llojeve te objekteve social-kulturore dhe te trashegimise kulturore;
- Zbatimi i planeve për ndërtimin e objekteve për ruajtjen e linjës dhe peizazhit natyral, në implementim të projekteve te pyllëzimit, krijimin dhe zhvillimin e turizmit natyror, bregdetar, malor, kodrinor dhe çdo veprimtarie në fushën turistike.

Si edhe çdo aktivitet tjetër që shërben për realizimin e aktiviteteve të mësipërme dhe çdo aktivitet tregtar i lejuar nga legjislacioni shqiptar.

### *Neni 3*

Shoqëria, në bazë të legjislacionit shqiptar, ka të drejtë të hapë filiale, degë, përfaqësi dhe të japë përfaqësimin në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si edhe jashtë saj në përputhje me legjislacionin e vendeve ku ato do të hapen.

---



*Neni 4*

Selia e shoqërisë tregtare është në Adresën: Rruga e "Kosovarëve", Ndërtesa 35, Hyrja 6, Ap.4/1, Njësia Administrative Nr. 5, 1019, Tiranë, Shqipëri.

*Neni 5*

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë tregtare është për një periudhë të paraktuar.

**KREU II**

**KAPITALI I SHOQËRISË**

*Neni 6*

Kapitali Themeltar i shoqërisë tregtare është 500,000 (pesëqindmijë) Lekë.

Kapitali Themeltar përbëhet nga 5 kuota.

*Neni 7*

Ortaku "Zurich Investment Group" shpk., zotëron një kuotë me vlerë 180,000 lekë dhe përfaqëson një pjesëmarrje prej 36% në Kapitalin Themeltar.

Ortaku Armand Metani, zotëron një kuotë me vlerë 150,000 lekë dhe përfaqëson një pjesëmarrje prej 30% në Kapitalin Themeltar.

Ortaku Altin Premti, zotëron një kuotë me vlerë 70,000 lekë dhe përfaqëson një pjesëmarrje prej 14% në Kapitalin Themeltar.

Ortaku Andi Eftihimi, zotëron një kuotë me vlerë 50,000 lekë dhe përfaqëson një pjesëmarrje prej 10% në Kapitalin Themeltar.

Ortaku Olsi Eftihimi, zotëron një kuotë me vlerë 50,000 lekë dhe përfaqëson një pjesëmarrje prej 10% në Kapitalin Themeltar.


*Neni 8*

Kapitali Themeltar përfaqëson kontribut në para. Shoqëria mund të zmadhojë ose zvogëlojë kapitalin e saj, por jo më shumë se kufiri minimal ligjor.

*Neni 9*

Zmadhimi i Kapitalit bëhet me vendim të Asamblesë së Ortakëve që zotërojnë shumicën e kualifikuar të Kapitalit Themeltar.

---



Zmadhimi i Kapitalit me anë të nënshkrimeve të pjesëve të Kapitalit Themeltar me kontribute në para, bëhet sipas Ligjit Tregtar.

Zmadhimi i kapitalit plotësisht ose pjesërisht me anë të kontributeve në natyrë, bëhet sipas kërkesave të Ligjit Tregtar. Eksperti i autorizuar për kontributet bën vlerësimin përkatës të kontributeve dhe i dorëzohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit bashkë me dokumentet justifikuese.

Zvogëlimi i Kapitalit vendoset nga Asambleja e Ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për zmadhimin e kapitalit.

#### *Neni 10*

Kuorumi, në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30% të kuotave.

Në rastin kur Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas Nenit 87 të Ligjit Tregtar dhe sa parashikohet nga ky Statut dhe Akt Themelimi, mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, si parashikuar në ligj dhe në këtë Statut dhe Akt Themelimi.

Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonëse 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

#### *Neni 11*


Procedura e transferimit të Kuotave tek të tretët do të realizohet në përputhje me Nenin 73 të Ligjit Tregtar. Kuotat e kapitalit mund të kalohen nëpërmjet:

- a) shitblerjes me kontratë me shkrim;
- b) trashëgimisë;
- c) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në çdo rast të kalimit të kuotave tek të tretët, ortakët kanë të drejtën e parablerjes dhe të miratimit paraprak të veprimit juridik. Pjesët e Kapitalit Themeltar mund t'u transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në Shoqëri, vetëm në qoftë se ortakët e tjerë nuk pranojnë të blejnë kuotën e kapitalit themeltar të ortakut-shitës, në rastin e transferimit me kontratë shihte dhe në të gjitha rastet vetëm me miratimin e Asamblesë së Ortakëve.

Çdo Transferim i Kuotave të Shoqërisë nga ndonjë prej Ortakëve tek një palë e tretë, do t'i nënshtrohet të drejtës së parablerjes nga Ortaku tjetër ("Pala që Gëzon të Drejtën"), e drejtë e cila do të ushtrohet në mënyrën e parashikuar në këtë Statut:

---



4

(a) Ortaku që ka qëllim të Transferojë Kuotat (“**Shitësi**”), do t’i japë Palës që Gëzon të Drejtën një njoftim me shkrim të dërguar me postë me lajmërim marrje (“**Njoftimi i Shitësit**”), mbi qëllimin e tij për të Transferuar të gjithë ose një pjesë të Kuotës. Në njoftimin e tij, Shitësi do tu njoftojë Palëve që Gëzojnë të Drejtat, duke përcaktuar koutën apo pjesën e Kuotës (ose përqindjen e interesit në kapital) që do të Transferojë, çmimin e propozuar, identitetin e palës së tretë blerëse të cilës Shitësi propozon t’i shesë Kuotën e tij, si dhe të gjitha kushtet materiale të tjera mbi bazën e të cilave ai ofron për shitje këtë Kuotë (apo pjesë të saj), përfshirë deklaratimet dhe garancitë (“**Kuota e Ofruar**”).

(b) Pala që Gëzon të Drejtën, e cila interesohet të ushtrojë të drejtën e parablerjes (“**Pala e Interesuar**”), do t’i komunikojë Shitësit me shkrim nëpërmjet postës me lajmërim marrje dhe jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e marrjes së Njoftimit të Shitësit (“**Periudha e Pranimit**”), vendimin e saj të parëvokueshëm për të ushtruar të drejtën e parablerjes (“**Përgjigja**”), ku specifikohet qëllimi i saj për të blerë Kuotën e Ofruar.

(c) Nëse Pala që Gëzon të Drejtën nuk i përgjigjet Njoftimit të Shitësit brenda periudhës së përcaktuar më lart dhe në formën e duhur, do të quhet se ajo ka hequr dorë nga ushtrimi i të drejtës së parablerjes në lidhje me Kuotën e Ofruar.


(d) Nëse ndonje Palë e Interesuar ka dërguar Përgjigje, Shitësi dhe Pala e Interesuar brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga ky komunikim do të lidhin një marrëveshje detyruese për shitblerjen e Kuotës të Ofruar. Shitësi është i detyruar të shesë Kuotën e Ofruar për atë çmim dhe me ato kushte të përshkruara në Njoftimin e Shitësit. Nëse Pala e Interesuar dhe Shitësi nuk e nënshkruajnë këtë marrëveshje shitblerje kuotash brenda afatit të përcaktuar këtu, dhe kjo nuk vjen si pasojë e neglizhencës ose e pakujdesisë me dashje të Shitësit, Pala e Interesuar do të konsiderohet se ka hequr dorë nga ushtrimi i së drejtës së parablerjes në lidhje me Kuotën e Ofruar.

(e) Nëse Përgjigjet dërgohen nga Pala e Interesuar për më pak se pjesa e Kuotës të Ofruar, Shitësi ka të drejtë në diskrecionin e tij të (i) tërheqë Njoftimin e Shitësit dhe të mbajë të gjithë Kuotën e Ofruar; ose (ii) t’i transferojë të gjithë Kuotën e Ofruar tek një palë e tretë blerëse për jo më pak se çmimi i specifikuar dhe për kushtet e ofertës së përcaktuar në Njoftimin e Shitësit. Shitësi do të përcaktojë nëse zgjedh opsionin (i) ose (ii) me njoftim dërguar Palës së Interesuar brenda 5 (pesë) ditëve nga përfundimi i Periudhës së Pranimit. Nëse ai nuk zgjedh, do të konsiderohet se ka zgjedhur opsionin (i).

(f) Nëse Pala që Gëzon të Drejtën komunikon qëllimin e saj për të mos ushtruar të drejtën e saj të parablerjes ose konsiderohet se ka hequr dorë nga ushtrimi i së drejtës së saj të parablerjes, Shitësi është i lirë ta shesë Kuotën e Ofruar palës së tretë, por vetëm për një çmim të barabartë ose më të lartë se çmimi i vendosur në Njoftimin e Shitësit dhe për të njëjtat kushte të përshkruara në Njoftimin e Shitësit me kushtin që menjëherë pas përmbushjes së kësaj shitje, Shitësi do t’i dorëzojë Ortakut tjetër një provë me shkrim ku vërtetohet kjo shitje.

(g) Në rast se Kuotat e Ofruara nuk shiten brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data kur Shitësi është i lirë për të shitur Kuotën e Ofruar tek një palë e tretë, atëherë, e drejta e parablerjes

---



5

e Palës që gëzon të Drejtën do të jetë sërish e zbatueshme në lidhje me Kuotën e Ofruar me të njëjtat kushte si më parë kur Kuota ishte ofruar për shitje.

Transferimi i kuotës/pjesës së kuotës, realizohet me vendim me shumicë të thjeshtë të asamblesë së përgjithshme dhe do të kryhet me veprimin juridik përkatës të miratuar nga asambleja e përgjithshme, ku do të identifikohet: (a) data e transfertës e cila është data e veprimit juridik përkatës; (b) emri dhe adresa e banimit/selia e Ortakut shitës dhe blerësit Ortak apo palë e tretë, dhe (c) vlera e transaksionit.

Cdo transferim i kuotes ne kundërshtim me kete nen do te konsiderohet si i pavlefshem dhe nuk do te prodhoje efekt per palet e perfshira dhe/apo shoqerine.

Transferimi i Kuotës do të regjistrohet në regjistrin e shoqërive tregtare dhe nga ky moment, ortaku do të ketë të drejtën e ushtrimit të të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga kuota dhe pjesëmarrja.

### KREU III

#### ORGANIZIMI DHE ADMINISTRIMI

##### *Neni 12*

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e Ortakëve.
- Administratori.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me Vendim të Asamblesë së Ortakëve.

Përveç kësaj administratori shkarkohet nga gjykata, për shkelje të ligjit me kërkesë të çdonjërit prej ortakëve.

##### *Neni 13*

Organi më i lartë vendimmarrës i shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë. Autorizimi jepet në formë shkresore vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme dhe është i vlefshëm edhe për mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Vendimet e tyre evidentohen në një Regjistër.

---



6


#### *Neni 14*

Asambleja e Përgjithshme vendos për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin, pranimin e largimit dhe shkarkimin e administratorit/ëve;
- ç) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertit/ëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin dhe anulimin e e kuotave;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) marrjen dhe dhënien e kredive, financimeve apo huave nga Shoqëria apo prej shoqërisë në favor të palëve të treta apo një prej Ortakëve;
- j) miratimin e kërkesës për vendosje të barrës mbi një kuotë në rast të marrjes së huasë nga Ortaku;
- k) marrjen e kredive, financimeve apo huave nga banka apo palë të treta;
- l) vendosjen e kuotave si kolateral për sigurimin e përmbushjes së marrëveshjeve të kredisë, financimit apo huasë nga banka apo palë të treta;
- m) miratimin e transaksioneve për shitjen, transferimin, asgjësimin, apo çdo veprim tjetër me asetet e shoqërisë; për dhënien e garancive; blerjen e aseteve;
- n) miratimin e pjesëmarrjes në kapitalin e shoqërive të tjera, hapjes së degëve, filialeve apo çdo disponim tjetër, në përputhje me legjislacionin në fuqi në vendin ku kjo e drejtë do të ushtrohet.

Si edhe çdo çështje tjetër të parashikuara nga ligji.

---



### *Neni 15*

Asambleja e Përgjithshme miraton llogaritë vjetore, pas raportit të ekspertit kontabël të autorizuar.

Ortaku ka të drejtë të marrë në çdo moment dokumentet e sipërpërmendura, për 3 vitet e fundit financiarë. Ai mund të ndihmohet nga një ekspert i zgjedhur prej tij, i cili i nënshtrohet detyrimit për ruajtjen e sekretit.

### *Neni 16*

Asambleja thirret nëpërmjet një njoftimi me shkrësë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkrësë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës dhe u dërgohet ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë dhe vendimmarrja bëhet në përputhje me ligjin dhe me aktet e themelimit të shoqërisë.

Mbledhja konsiderohet e thirrur në përputhje me ligjin dhe mbahet e rregullt në përputhje me arritjen e kuorunit të parashikuar në ligj. Ortakët, që nuk janë të pranishëm, kanë mundësinë e pjesëmarrjes në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme me mjete të ndryshme komunikimi, përfshirë mjete elektronike, me kusht që të garantohet identifikimi i ortakëve.

### *Neni 17*

Ndryshimet në Statutin e Shoqërisë vendosen nga Asambleja e Ortakëve në përputhje me shumicën e parashikuar në ligj.

Në kushtet e mësipërme, Asambleja vendos edhe për çështje të tjera që Ligji "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", u referohet shprehimisht.


Në asnjë rast, nuk mund të detyrohet një ortak për të rritur angazhimin e tij në Kapitalin Themeltar të shoqërisë.

### *Neni 18*

Administratori i Shoqërisë zgjidhet Armand Metani, për një mandat 12-mujor me të drejtë rizgjedhje.

Ndryshimi i administratorit kryhet me vendim të marrë nga shumica e thjeshtë e Asamblesë së Përgjithshme dhe Ortakët kanë të drejtë të zgjidhen administratorë për një mandat të caktuar dhe të kufizuar në kohë, me të drejtë rizgjedhje.

Administratori ka të drejtë të dorëhiqet me një njoftim drejtuar Asamblesë të paktën 30 ditë përpara drejtuar Ortakëve. Asambleja do të thirret nga Ortaku mazhoritar, me rend dite për pranimin e dorëheqjes dhe caktimin e administratorit të ri. Derisa vendimi për ndryshimin e administratorit në këto kushte nuk është regjistruar në Regjistrin Tregtar, administratori në fuqi mban përgjegjësi dhe ushtron të gjitha detyrat e administrimit vetë, apo nëpërmjet një autorizimi të dhënë për llogari të një prej ortakëve, apo një pale të tretë punonjës apo jo në Shoqëri.





## Neni 19

Përveçse rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë Statut apo ndonjë vendim të Asamblesë së Ortakëve, Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër dhe për llogari të shoqërisë, në të gjitha rrethanat, me përjashtim të kompetencave që Ligji apo Statuti ia jep Asamblesë së Ortakëve.

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet lidhur me administrimin e shoqërisë.

Administratori redakton raportin e administrimit, inventarin dhe llogaritë vjetore.

Administratori ka të drejtë të hyjë në marrëdhënie kontraktore në emër dhe për llogari të shoqërisë ku përfshihen, dhe duke mos u kufizuar vetëm në:


- a) Ndjekja e të gjitha procedurave administrative lidhur me marrjen e licencave për ushtrim aktiviteti, marrjen e lejeve, autorizimeve të nevojshme si dhe çdo dokumenti tjetër të nevojshëm, pa kufizim nga organet kompetente, si dhe realizimin e interesave të shoqërisë, në kuadër të marrëdhënieve me organet e pushtetit vendor dhe qendror.
- b) Nënshkrimi i Kontratave Individuale të Punës si dhe zgjidhja e tyre.
- c) Nënshkrimi i Kontratave të Sipërmarrjes, Porosisë, të Shkëmbimit, të Furnizimit, Qirasë, Premtim-Shitje, Kontratave të Shitjes etj., në kuadër të përmbushjes së objektit të veprimtarisë së shoqërisë.
- d) Të përfaqësojë shoqërinë në kryerjen e veprimeve bankare me llogaritë bankare që shoqëria ka pranë bankave të nivelit të dytë, duke pasur të drejtë të kryejë çdo veprim me to si lërheqje, depozitime, transfertat etj.
- e) Si dhe të gjitha veprimet e tjera juridike të shoqërisë, të cilat nuk përfshihen në kompetencat e Asamblesë së Ortakëve.

Pavarësisht nga çdo gjë më sipër, kompetencat e Administratorit do të jenë të kufizuara nga nënshkrimi i Z. Alban Efilimi, përfaqësues i Ortakut "Zurich Investment Group" shpk, për të gjitha veprimet apo pagesat që e kalojnë vlerën 1.000.000 lekë pa TVSH (apo ekuivalenten e kësaj vlere në monedhë të huaj) dhe ose të gjitha zotimet kontraktuale mbi bazën e të cilave Shoqëria pret të marrë ose prit të kryejë pagesa, përfitime ose punë dhe shërbime në një vlerë më të madhe se 1.000.000 lekë pa TVSH (apo ekuivalenten e kësaj vlere në monedhë të huaj) përgjatë kohëzgjatjes së kontratës përkatëse.

Kufizimet e parashikuara në paragrafin mësipër, nuk zbatohen për pagesa që kryhen nga Shoqëria për autoritetet tatimore (taksa, tatime).

Gjithashtu, Administratori nuk mund të kryejë aktivitetet e mëposhtme pa miratimin paraprak me shkrim të Asamblesë, apo një ortaku që asambleja ka vendosur të zgjedhë për të kryer këtë miratim (në vijim "Ortaku Miratues"):

---



9

- (i) vendime të cilat janë në kompetencën ekskluzive të Asamblesë;
- (ii) barrësimin e operacioneve të Shoqërisë, fondeve të saj, aseteve ose pretendimeve jashtë fushës normale të Biznesit;
- (iii) të gjithë investimet kapitale ose disponimi i aseteve të cilat nuk janë miratuar në buxhet
- (iv) të marrë kredi dhe/ose qira financiare dhe/ose instrumentave financiare që përfaqësojnë një borxh të Shoqërisë ndaj palëve të treta;
- (v) blerja dhe/ose transferimi dhe ose/tjetersimi në çdo formë i pasurive të paluajtshme të Shoqërisë (pa përfshirë pasuritë e paluajtshme të cilat Shoqëria i shet për shkak të Biznesit);
- (vi) dhënia e garancive, sigurimi ose kompensimi për përmbushjen e detyrimeve ndaj palëve të treta;

Administratori gëzon të drejtën e përfaqësimit të shoqërisë në marrëdhënie me të tretët, gjithashtu edhe përpara të gjitha organeve shtetërore, administrative e gjyqësore të të gjitha instancave.

Administratori mund të delegojë tek një person i punësuar në shoqëri apo tek Ortakët e saj të gjitha apo disa nga kompetencat/ të drejtat që ai ka në bazë të këtij statuti. Këta persona do të kenë të drejtë të veprojnë në emër dhe për llogari të shoqërisë, brenda tagreve që vetë administratori gëzon, sipas këtij Statuti. Në të gjitha rastet për çdo tejkallim të kompetencave nga personi i tretë, administratori do të përgjigjet kundrejt shoqërisë.

Administratori është përgjegjës, sipas rastit, ndaj shoqërisë dhe të tretëve për shkelje të Statutit apo fajë të kryera gjate administrimit të Shoqërisë.

#### KREU IV

#### MARRËDHËNIET EKONOMIKO - FINANCIARE

##### *Neni 20*

Viti financiar fillon më datën 1 Janar dhe mbaron më datën 31 Dhjetor të çdo viti, me përjashtim të vitit të parë, i cili fillon në datën e themelimit të shoqërisë.

Llogaritë vjetore, inventari, raportet dhe operacionet e vitit financiar dhe raportet e veçanta të hartuara nga administratorët dhe eventualisht nga eksperti kontabël, miratimi i bilanceve dhe i dokumentacionit mbi veprimtarinë vjetore, bëhet brenda 6 muajve, nga mbyllja e vitit financiar.

##### *Neni 21*

Llogaritë ekonomike dhe ato kontabël mbahen në gjuhën shqipe, në lekë ose në valutë të huaj.

---



10

Veprimtaria ekonomike mbahet në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore të dala për këtë qëllim dhe mbështetet në aktivin dhe pasivin, që detyrimisht do të pasqyrohen në bilanci c e përpiluara.

*Neni 22*

Shoqëria Tregtare, me qëllim që t'i bëjë sa më të lehta dhe më të shpejta pagesat me të tretët, do të hapë llogari bankare në një apo disa nga Bankat që janë të njohura nga shteti shqiptar, të cilat do të administrohen nga administratori.

**KREU V**

**PRISHJA, LIKUJDIMI**

*Neni 23*

Shoqëria priset me vendim të Asamblesë së Ortakëve me shumice të kualifikuar.

Shoqëria mund të shndërrohet në një nga format e përcaktuara nga ligji, sipas shumicës së kërkuar nga ligji për çdo rast konkret.

*Neni 24*

Shoqëria tregtare hyn në procesin e likujdimit që në momentin e vendosjes për prishjen e saj.

Për fillimin e këtij procesi, Asambleja e Ortakëve emëron një likujdues i cili paraqet:

1. raportin e likujdimit,
2. gjendjen e aktivit e të pasivit të Shoqërisë,
3. mënyrën e ndjekjes së operacionit të likujdimit dhe
4. afatin e nevojshëm për përfundimin e tyre.

Në fund të procesit të likujdimit, Asambleja e Ortakëve vendos mbi bilanci përfundimtar, mbi aktin dhe rregullsinë e likujdimit, mbi mbylljen e procesit të likujdimit të Shoqërisë.

*Neni 25*

Të gjitha mosmarrëveshjet që do të lindin gjatë ekzekutimit të këtij statuti dhe kontratës së themelimit, gjatë ekzistencës së Shoqërisë, si gjatë kryerjes së veprimtarisë, ashtu edhe në procesin e likujdimit, do të zgjidhen nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.



Neni 26

Për kryerjen e procedurave për dorëzimin e dokumentacionit dhe regjistrimin e Shoqërisë në QKB, autorizohet Z. Alban Efthimi, identifikuar me kartën e Identitetit Nr. 033198809, dhe Nr. Personal H80104093K

ORTAKËT

ZURICH INVESTMENT GROUP shpk.

Administratori

Alban EFTHIMI

*Alban Efthimi*  
*[Signature]*



Altin PREMTI

*Altin Premti*  
*[Signature]*

Andi EFTHIMI

*Andi Efthimi*  
*[Signature]*

Armand METANI

*Armand Metani*  
*[Signature]*

Olsi EFTHIMI

*OLSI EFTHIMI*  
*[Signature]*

20.07.2023